



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN
E SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI



MBI AUDITIMIN E “SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT” NË

UNIVERSITETIN E SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”

Tiranë, Dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	7
II.	HYRJJA	7
1	Objekti i auditimit	8
2	Qëllimi i auditimit	8
3	Identifikimi i çështjes	8
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
5	Përgjegjësitë e audituesve	9
6	Kriteret e vlerësimit	9
7	Standardet e auditimit	10
8	Metodat e auditimit	10
9	Dokumentimi i auditimit	10
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	11
2.1	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	11-16
	<i>Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK</i>	
	<i>Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit</i>	
2.2	Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit	16-19
a	<i>Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime.</i>	
b	<i>Procedurat e Investimeve në fushën TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të shërbimit.</i>	
2.3	Auditimi i Sigurisë së Informacionit	19-29
a	<i>Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet</i>	
b	<i>Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit</i>	
2.4	Auditimi i Sistemeve	29-34
a	<i>Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/output.</i>	
b	<i>Kontrolli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre</i>	
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	34

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
RSH	Republika e Shqipërisë
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
SPE	Sistemi i Prokurimit Publik
RASH	Rrjeti Akademik Shqiptar
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKCESK	Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
BCP	Business Continuity Plan
ALCIRT	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
BCC	Business Continuity Center
MNSH	Marrëveshjeve Nivel Shërbimi
AK	Autoriteti Kontraktues
OE	Operator Ekonomik
TI(IT)	Teknologjia e Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KM	Këshilli i Ministrave
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
COBIT	Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
BE	Bashkimi Evropian
SSL	Secure Sockets Layer
VPN	Virtual Private Network
LAN	Local area network
IP	Internet Protocol

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi, nga data 30.05.2022 deri më datë 30.09.2022.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi është pjesë e Planit Vjetor 2022 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Nga ana e subjektit janë përcjellë në KLSH dy kopje të Projektraportit të auditimit të shoqëruar me deklaratën e nënshkruar nga titullari i insitucionit Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e dërguara mbi akt konstatimet dhe projektraportin e auditimit. Në konsideratë janë marrë ato kundërshti për të cilat janë paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Mbështetur në punën audituese në terren, evidencat e marra kanë qenë të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar. Auditimi i sistemeve të Informacionit është e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Gjetje nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Universiteti i Shkodrës nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së USH-së. - Institucioni vepron bazuar në një rregullore të brendshme version i pa update-uar me ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në universitet, gjithashtu në këtë rregullore nuk janë të përfshira detyrat aktuale që drejtoria IT kryen 	faqe 11-16	E Lartë	<ul style="list-style-type: none"> -Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit, si dhe të marrë masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimin të objektivave të përcaktuara - Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën të pasqyrohen dhe reflektohen qartë detyrat operationale në lidhje me ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike.
2	<p>Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Shkodrës nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ për sa i përket arritjes së objektivave institucionale.</p>	faqe 11-16	E Lartë	<p>Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marr masa hartimin e regjistrit të riskut ku të përfshihen edhe risqet për Teknologjinë e Informacionit me qëllim identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe</p>

				dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin / parandalimin e risqeve të identifikuar, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.
3	Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Shkodrës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.	faqe 19-29	E Lartë	Strukturat Drejtuese në Universitetin e Shkodrës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.
4	Universiteti i Shkodrës kryen veprime operacionale të pjesshme në sisteme informatike minimaliste për nga funksionalitetet si dhe kostot. Punonjësit operojnë në dy sisteme, për të dhëna specifike duke i regjistruar ato manualisht në Pitagora dhe në SMAK, sepse të dhënat në Pitagora orientohen për nga studentët, ndërsa të dhënat në SMAK plotësojnë më mirë kërkesat e stafit akademik, ndihmës akademik si dhe administrativ.	faqe 29-34	E Lartë	Universiteti i Shkodrës, të analizojë dhe vlerësojë të gjitha mundësitë që informatizimet e pjesshme që ndihmojnë aktivitetin administrativ të universitetit t'i përmbledhë në një sistem informatik të vetëm, çfarë do të lehtësonte mirëmbajtjen dhe suportin nga punonjësit e sektorit IT, por dhe përdoruesit të cilët do të gjenin çdo informacion të nevojshëm brenda një sistemi
5	Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemeve informatike në USH, u konstatua se: -Nuk ka një udhëzues për sa i përket fjalëkalimeve, si ndryshimet në password, periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit.	faqe 29-34	E Lartë	Universiteti i Shkodrës të identifikojë dhe të miratojë një standard dhe akt rregullativë mbi menaxhimin e përdoruesve si një mjet i domosdoshëm i cili garanton gjurmën e veprimeve të përdoruesve dhe ofron një identifikim më

<p>- Për periudhën nën auditim, nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve në të cilin të përcaktohen qartë procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e përdoruesve. Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email.</p> <p>-Nuk ka një manual për administratorin e sistemit</p>			<p>të sigurt në sistemet informatike.</p>
---	--	--	---

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Kemi audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit për periudhën ushtrimore 01.01.2020-31.12.2021 në të cilat përfshihet Qeverisja IT, procedurat e prokurimeve TIK Siguria e Informacionit, Sistemet e Informacionit.

- Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH” datë 27.11.2014

- Sipas opinionit tonë, pas shqyrtimit të evidencave të marra Universiteti “Luigj Gurakuqi” ka në përdorim sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatorë për funksionimin e tyre . Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pa pamjaftueshëm. Në këtë drejtim, përdorimi i sistemeve mbart një risk të lartë në mbarëvajtjen e funksionaliteteve të ndërtuara në shërbim të qëllimit dhe objektivave institucionale

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 468/3, datë 27.05.2022 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 27.05.2022 deri në 30.09.2022, në Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi ku periudha e audituar është 01.01.2020 deri në 31.12.2021, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. R.A, Përgjegjës Grupi
2. B.H, Anëtar
3. E.C, Anëtare
4. M.P, Anëtare
5. A.K, Anëtare
6. K.S, Anëtare

II.1. Objekti i auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, është dhënia e opinionit apo vlerësimit nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë. Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efëçente. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

II.3 Identifikimi i çështjeve:

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr.468/3, datë 27.05.2022:

1.Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

- a. Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe burimeve njerëzore në TIK.
- b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit.

2.Auditimi i zhvillimit dhe i blerjes në Teknologjinë e Informacionit

- a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime.
- b. Procedurat e Investimeve në fushën TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të shërbimit.

3.Auditimi i Sigurisë së Informacionit

- a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit.
- b. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet.

4.Auditimi i Sistemeve

- a. Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/output.
- b. Kontrolli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre.

II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Universitetet synojmë të formojmë dhe të përgatisim, studentë premtues, profesionistë e cilësorë në përshtatje me trendin e tregut të punës, shkencetarë në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin kombëtar por edhe në atë europian e më gjerë, duke kaluar çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike apo kulturore. Misioni i Universiteteve është i orientuar në këto drejtime:

- Të kontribuojë në promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë të disiplinave të mësimdhënies dhe kërkimit.

- Të sigurojë mjetet e nevojshme për një karrierë të suksesshme për studentët, për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
- Të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të Shqipërisë dhe më gjerë.
- Të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit

II.5 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Universitetin e Shkodrës, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 31.12.2021, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 468/3, datë 27.05.2022 miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon Universiteti i Shkodrës. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve

II.6 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165)
- Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar
- Ligji Nr. 162 Date 23.12.2020 Për Prokurimin Publik.
- Ligji Nr 10296, datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore të zbatimit të tij.
- Ligji Nr 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”
- Legjislacioni mbi krimin Kibernetikë.
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”.
- Ligji Nr 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”
- Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik (Ndryshuar Me Vendimin Nr. 710, Datë 24.11.2021)
- Vendimi nr. 914, datë 29.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të Dhënave Shtetërore
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;
- Standardet TIK;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar;

II.7 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj

II.8 Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në Universitetin e Shkodrës, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;

II.9 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1 Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IPAL) në Republikën e Shqipërisë, i njohur me ligj si i tillë. Veprimtaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në këtë Statut dhe në rregulloret që miratohen, në zbatim të tyre. Universiteti i Shkodrës është person juridik publik që financohet nga Buxheti i

Shtetit ose vetëfinancohet nga burime të tjera të ligjshme. USH përfaqësohet nga Rektori për çështjet akademike dhe protokollare dhe nga administratori për çështjet financiare dhe administrative, sipas përcaktimeve të LAL-së. Universiteti i Shkodrës u krijua me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 167, datë 28 maj

Universiteti i Shkodrës ka si mision :

- Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet
- me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Gjithashtu, USH ka si mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj.
- Të japë njohuri bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme
- dhe aftësi specifike në një varietet të caktuar profesionesh dhe specialitetesh, sipas fushave që mbulon, si dhe të sigurojë arsimim dhe kualifikim të mëtejshëm profesional e shkencor.
- Të ushtrojë funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës për çdo tip formimi
- të nivelit të lartë, duke përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet
- me interes publik apo privat.
- Ka për detyrë të plotësojë standardet për të garantuar zhvillimin mësimor e atë shkencor
- në tri ciklet e studimit që ofron.
- Ka për detyrë të ndihmojë dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social – ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar, organizuar dhe kryer shërbime kulturore dhe formuese.

III.2. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

. Verifikimi i procedurave dhe burimeve njerëzore në TIK

Strategjia TIK

Universiteti i Shkodrës është krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 167, datë 28 maj 1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik , i hapur më 3 shtator 1957, që konsiderohet edhe data e krijimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Universiteti i Shkodrës ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Gjithashtu, USH ka si mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj. USH ka për detyrë të japë njohuri bazë me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të caktuar profesionesh dhe specialitetesh, sipas fushave që mbulon, si dhe të sigurojë arsimim dhe kualifikim të mëtejshëm profesional e shkencor. USH ushtron funksionet themelore të kërkimit shkencor dhe të didaktikës për çdo tip formimi të nivelit të lartë, duke përfshirë orientimin, formimin e përhershëm dhe përditësimin kulturor e profesional, veprimtaritë bazë apo plotësuese për to, si dhe kërkimin e aplikuar për problemet me interes publik apo privat. USH ka për detyrë të plotësojë standardet për të garantuar zhvillimin mësimor e atë shkencor në tri ciklet e studimit që ofron. USH ka për detyrë të ndihmojë dhe të mbështesë zhvillimin kulturor e social – ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke promovuar, organizuar dhe kryer shërbime kulturore dhe formuese.

Organet kolegjiale në USH janë:

- a) Asambleja e personelit akademik
- b) Senati Akademik
- c) Komisionet e përhershme.

- d) Rektorati
- e) Dekanati
- f) Bordi i Administrimit
- g) Këshilli i Etikës

USH ka të drejtë të krijojë në strukturën e vet organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve në Statut. USH për realizimin e misionit të vet dhe të veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore është i organizuar në këto njësi përbërëse:

- a) Njësi kryesore / Fakultetet / Institutet kërkimore-shkencore;
- b) Njësi bazë / departamentet / qendrat kërkimore shkencore;
- c) Njësi ndihmëse akademike dhe administrative.

Njësi kryesore të USH-së janë fakultetet. Fakulteti është njësi kryesore e përbërë së paku nga tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente.

Fakulteti është njësi kryesore e USH-së që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura dhe ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme në përfundim të të cilave lëshon diplomën përkatëse.

USH ka në përbërjen e tij gjashtë fakultete:

- Fakultetin e Shkencave Natyrore;
- Fakultetin e Shkencave Shoqërore;
- Fakultetin e Drejtësisë;
- Fakultetin Ekonomik;
- Fakultetin e Gjuhëve të Huaja;
- Fakultetin e Shkencave të Edukimit.

Autoritetet drejtuese të USH-së

Autoritete drejtuese të USH-së janë:

- a) rektori;
- b) administratori i USH-së;
- c) drejtuesit e njësive kryesore (dekanët);
- d) administratorët e njësive kryesore
- e) drejtuesit e njësive bazë (Drejtorët e departamenteve)
- f) administratori i njësisë bazë

- Strukturat e Teknologjisë së Informacionit sipas Nenit 47 “Personeli ndihmës akademik” të Statutit të USH është Strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucional.

Universiteti i Shkodrës ka miratuar me shkresën nr. 722 prot., datë 24.02.2017 Strategjinë Sektoriale të Universitetit të Shkodrës. Plani Strategjik i USH 2017-2021 është mbështetur në disa prioritetë ku një prej të cilave është dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit e cila parashtron synime dhe objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm për sistemin si dhe paraqet politikat dhe prioritetet strategjike për vitet që pasojnë.

- Nga auditimi u konstatua se, aktualisht Universiteti i Shkodrës nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së USH-së.

Universiteti i Shkodrës kryen detyrat funksionale bazuar në Rregulloren e Brendshme miratuar më datë 28.06.2010. kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë administrative të USH-së në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj.

- Nga auditimi u konstatua se, institucioni vepron bazuar në një rregullore të brendshme version i pa update-uar me ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në universitet, gjithashtu në këtë rregullore nuk janë të përfshira detyrat aktuale që drejtoria IT kryen.

Politikat dhe burimet njerëzore në TIK

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, struktura e përgjithshme në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër është e miratuar me vendim të Kryetarit të Bordit të Administrimit nr. 95, datë 26.04.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të USH-së për vitin 2022”, si dhe është bërë riorganizimi i strukturës IT me Vendim nr. 270, datë 17.09.2020 “Për riorganizimin e Drejtorisë së IT-së dhe dy sektorëve të tjerë”.

Tabela nr. 2: Struktura e Drejtorisë së IT

Nr.	Emërtimi	Nr. punonjës
1	Drejtor	1
Sektori i Menaxhimit të Sistemit		3
2	Përgjegjës Sektori	1
3	Specialist IT	2
Sektori i Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes IT		3
4	Përgjegjës Sektori	1
5	Specialist IT	2
Total		7

Burimi: USH, përpunuar nga grupi i auditimit

- Nga dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga USH, konstatohet se përshkrimet e punës për stafin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit mbi mënyrën, organizimin, funksionimin dhe ndarjen e përgjegjësive specifike të roleve, punëve dhe veprimeve operacionale brenda drejtorisë, nuk janë të miratuara por i janë paraqitur grupit të auditimit si Relacionin drejtuar Rektorit të Universitetit me nr. 2657 prot., datë 08.10.2020.

Gjithashtu, konstatohet se përshkrimet e punës nuk janë të përfshira në rregulloren e brendshme të Universitetit të Shkodrës.

➤ **Trajnimet**

Trajnimi është një nga shtyllat e rëndësishme për menaxhimin e kapaciteteve. Personeli që ka akses në asetet dhe sistemet e teknologjisë së informacionit të Universitetit të Shkodrës të jetë i vetëdijshëm për rregullat dhe standardet e sigurisë dhe të jenë të aftë t'i zbatojnë dhe ndjekin ato gjatë punës së tyre.

Është e nevojshme që procesi të mbështetet në një identifikim dhe analizë të nevojave për trajnim të stafit, me qëllim që të sigurohet parashikimi, programimi dhe implementimi i suksesshëm i veprimtarive trajnuese.

- Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Universiteti i Shkodrës, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitin 2020 - 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Kjo në kundërshtim me rregulloren e brendshme në të cilën përcaktohet se Burimet Njerëzore të cilat bëjnë identifikimin e nevojave për trajnim të personelit, harton dhe zbaton programe trajnimi të veçanta në përputhje me nevojat e institucionit.

➤ **Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK**

Nga administrimi i dokumentacionit sesi Universiteti i Shkodrës identifikon dhe menaxhon risqet institucionale dhe risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se USH nuk disponon regjistër rrishtu të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe

të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. USH nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përse i përket arritjes së objektivave institucionale.

Nisur sa më sipër dhe mbështetur në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Universiteti i Shkodrës nuk dispononë regjistër risku ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

1.Titulli i gjetjes: Mungesë e planifikimit strategjik mbi teknologjinë e informacionit. Mos përditësimi i rregullores së brendshme administrative, për funksionimin e Universitetit të Shkodrës.

Situata: Nga auditimi u konstatua se:
- Universiteti i Shkodrës nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së USH-së.
- Institucioni vepron bazuar në një rregullore të brendshme version i pa update-uar me ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në universitet, gjithashtu në këtë rregullore nuk janë të përfshira detyrat aktuale që drejtoria IT kryen.

Kriteri: Rregullore e Brendshme miratuar më datë 28.06.2010.

Ndikimi/Efekti: Mos arritje e objektivave institucionale si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi.

Shkaku: Mos menaxhim si dhe mos miratim në bazën ligjore, nënligjore dhe aktet rregullative.

Rëndësia: E Lartë.

1.1. Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit, si dhe të marrë masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësimit të objektivave të përcaktuara.

1.2. Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën të pasqyrohen dhe reflektohen qartë detyrat operacionale në lidhje me ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike.

2.Titulli i gjetjes: Mos përditësimi i rregullores së brendshme administrative.

Situata: Nga auditimi u konstatua se:

- Në Universitetin e Shkodrës përshkrimet e punës për stafin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit mbi mënyrën, organizimin, funksionimin dhe ndarjen e përgjegjësive specifike të roleve, punëve dhe veprimeve operacionale brenda drejtorisë, nuk janë të miratuara por i janë paraqitur grupit të auditimit si Relacionin drejtuar Rektorit të Universitetit me nr. 2657 prot., datë 08.10.2020.
- Përshkrimet e punës nuk janë të përfshira në rregulloren e brendshme të Universitetit të Shkodrës.

Kriteri: Rregullore e Brendshme e administratës të Universitetit të Shkodrës.
Ndikimi/Efekti: Mos arritje e objektivave institucionale si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive.
Shkaku: Mos menaxhim si dhe mos miratim në bazën ligjore, nënligjore dhe aktet rregullative.
Rëndësia: E Lartë.
2.1.Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën të pasqyrohen dhe reflektohen qartë detyrat operacionale. Gjithashtu, të marren masa dhe për përfshirjen e detyrave funksionale të punonjësve në rregulloren e brendshme.

3.Titulli i gjetjes: Mungesa e parashikimit dhe zhvillimit të trajnimeve.
Situata: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Universiteti i Shkodrës, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2020 - 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Kjo në kundërshtim me rregulloren e brendshme në të cilën përcaktohet se Burimet Njerëzore të cilat bëjnë identifikimin e nevojave për trajnim të personelit, harton dhe zbaton programe trajnimi të veçanta në përputhje me nevojat e institucionit.
Kriteri: Rregullore e Brendshme miratuar më datë 28.06.2010.

Ndikimi/Efekti: Risk në mos përmbushje të objektivave të përcaktuara.
Shkaku: Mungesë planifikimi për zhvillimin e trajnimeve për burimet njerëzore.
Rëndësia: E mesme.
3.1.Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit i cili merret me administrimin e bazës së të dhënave dhe të çdo përdoruesi të sistemit, si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

4.Titulli i gjetjes: Identifikimi i risqeve në Teknologjinë e Informacionit
Situata: Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Shkodrës nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ për sa i përket arritjes së objektivave institucionale.

Kriteri:	Neni 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mos identifikim, mos adresim i problematikave që mund të shfaqen, shkelje e sigurisë.
Shkaku:	Mos update-im i regjistrit të riskut
Rëndësia:	E Lartë.
4.1.Rekomandimi:	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marr masa hartimin e regjistrit të riskut ku të përfshihen edhe risqet për Teknologjinë e Informacionit me qëllim identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin / parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

II.2.2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

a) Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime.

b) Procedurat e Investimeve në fushën TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të shërbimit.

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit nr. 468/3, datë 27.05.2022 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Në zbatim të programit të auditimit të sipërcituar, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Urdhrat e Prokurimit;
- Kontratat e shërbimit;
- Specifikimet Teknike;
- Raportet e monitorimit;
- Urdhërat e brendshëm për marrje në dorëzim të shërbimit;
- Situacionet e mirëmbajtjes;
- Procesverbalet e marrjes në dorëzim të shërbimit;
- Faturat tatimore të likuidimeve të vlerave mujore për shërbimet e kryera.

Objekti i këtij akt konstatimi është:

Verifikimi sesi Universiteti identifikon, prioritarizon dhe menaxhon kërkesat për sistemet e IT që ka zhvilluar ndër vite.

Auditimi zhvillimit dhe Blerjes në Teknologjinë e Informacionit

Procedura e prokurimit publik me objekt “Blerje pajisje elektronike dhe të laboratorit historik”

1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1391 Prot., datë 22.04.2021	3. Hartuesit e specifikimeve teknike: I.H M.P S.I	4. Komisioni i llogaritjes se fondit limit: I.H M.P S.I
2. Fondi Limit (pa tvsh) 25.774.327 lekë:		

5. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”	6. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: I.H M.P S.I	7. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: R.B S.Ç E.SH
8. Data e hapjes së tenderit: 22.04.2021	9. Operatori fitues: “PS” Vlera e ofertës fituese, pa TVSH, 23.916.800 lekë:	10. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1.857.527 lekë
11. Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 2 (dy)	12. Operatore te Kualifikuar: 1 (një)	13. Operatorë të skualifikuar: 1 (një)
14. Ankimimet: Nuk ka	15. Përgjigje Ankesës nga AK Nuk ka	16. Përgjigje Ankesës nga KPP: Nuk ka
17. Marrja në Dorëzim Datë 25.08.2021	18. Vlera e kontratës (me tvsh): 28.700.160 lekë	19. Afati i kontratës

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu, edhe në për llogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

-Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

-Përzgjedhja e operatorit fitues: Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

- Operatori ekonomik: “P.S” ka paraqitur dokumentacionin dhe është vërejtur nga KVO se autorizimi i dorëzuar mbi marrëveshjen e kompanisë ITD shpk me kompaninë Samsung Electronics Austria GmbH nuk ishte i qartë, nëse ishte versioni origjinal apo një kopje e noterizuar. Pas kërkesës për sqarim në mënyrë elektronike operatori ekonomik ka paraqitur përgjigjen brenda afatit të përcaktuar dhe pas vlerësimit të komisionit si të rregullt, e kualifikoi ofertën.

- Operatori ekonomik: “A” është refuzuar për shkak se formulari i sigurimit i paraqitur nga ana e operatorit nuk i është përmbajtur vlerës së kërkuar pasi vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës ka qenë 2% në masën 515.487 Lekë (Pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) Lekë.

-Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Më datë 25.08.2021 komisioni i marrjes në dorëzim me shkresën nr. 2747 Prot. ka bërë me dije se më datë 25.08.2021 është nënshkruar procesverbali i marrjes në dorëzim nga dy palët. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka

kërkuar nga operatori ekonomik zëvendësimin e një artikulli, i cili është refuzuar për shkak se nuk ishte konform specifikimeve teknike dhe përpos faktit se OE deklaroi se artikulli që ka dërguar si zëvendësues i plotëson specifikimet dhe i tejkalon ato, komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka pranuar.

OE "PS" brenda afatit të kontratës ka lëvruar 25 nga 27 artikuj në total nga të cilat sipas pretendimit të Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër një artikull nuk i plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në kontratë. Për pasojë një artikull iu kthye për plotësim sipas faturës dhe procesverbalit të mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim me urdhrin e administratorit nr. 1391/13 Prot. datë 13.07.2021. OE është informuar që të vijojnë me plotësimin dhe zëvendësimin e artikujve, në zbatim të kontratës me vonesë sipas nenit 23 dhe 24.

Autoriteti kontraktor Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe kontraktuesi "PS" shpk kanë nënshkruar kontratën me nr. 1391/4 Prot. datë 12.07.2021 me objekt "Blerje pajisje elektronike dhe të laboratorit të fjalorit historik". Sigurimi i kontratës prej (10 % të vlerës së ofertës) është në masën 2,870,016 Lekë, e cila është lëshuar nga kompania e sigurimeve për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij në bazë të kontratës.

Me shkresën nr. 304 Prot. datë 25.08.2021 OE ka kërkuar nga kontraktuesi zgjatje të afatit të kontratës me afat 30 ditë pune nga data 26.08.2021 pasi sipas pretendimit të tyre për shkak se përfaqësuesi i autorizuar i pajisjeve Lexmark, ka informuar kontraktuesin PS për vonesa në lidhje me lëvrimin e pajisjeve për arsye shkak të problematikave të cilat i kanë parashtruar në shkresën e dërguar autoritetit kontraktor. AK nuk e ka miratuar zgjatjen e afatit e kërkuar nga OE.

Më 01.09.2021 me shkresën nr. 401 Prot. OE ka parashtruar se ka lëvruar mallrat mbi realizimin e kontratës, por komisioni i AK për marrjen në dorëzim e ka kundërshtuar pranimin e mallit për arsye se nuk përputhej me specifikimet teknike të parashtruara në kontratë. OE ka deklaruar se do të lëvrojë pranë AK produkte me specifikime teknike më cilësore dhe kostot do ti mbulojë kontraktuesi.

Me shkresën nr. 304/1 Prot. datë 13.09.2021 ka ofertuar që në mungesë të pajisjeve Lexmark sipas kontratës të bëjë zëvendësimin me pajisje HP i cili ishte stok në magazinat e prodhuesit dhe mund të bëhej lëvrimi i tyre brenda datës 25.09.2021.

Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër i ka dërguar një shkresë Administratores së Universitetit të Shkodrës, drejtorisë juridike me nr. 2747 Prot. datë 16.09.2021, ku ka informuar se për shkak të problematikave të hasura me OE mbi lëvrimin e mallrave dhe shkeljes së afateve nga ana e tyre, AK ka deklaruar se nuk mund të procedoj më tej.

Me shkresën nr. 2946 Prot. datë 27.09.2021 Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër ka njoftuar OE "PS" se në kushtet e shkeljes së afateve të përcaktuara në kontratën dhe problematikave të hasura në përmbushjen e saj, referuar nenit 24 të kontratës, ka bërë me dije OE se vlera e dëmit mbi vonesën është 28.700,70 Lekë në ditë. Me shkresën 2946/1 Prot. datë 28.09.2021, Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër ka kërkuar plotësimin e menjëhershëm të kontratës.

Me shkresën 2981 Prot. datë 29.09.2021, OE ka njoftuar AK se i është bërë me dije se mallrat do të mbërrijnë në Shqipëri në datat 5-8 tetor. Për realizimin e kontratës dhe përmbushjen e kontratës OE ka kërkuar që ky njoftim të merret në konsideratë nga AK. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë shkresë në të cilën të faktohet nëse AK e ka marrë në konsideratë shkresën e dërguar nga grupi i marrjes në dorëzim të anulujë procesverbalin e marrjes në dorëzim.

Me shkresën nr. 3161 Prot. datë 07.10.2021 Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër drejtuar Administratores së USH, ka kërkuar tërheqjen e mallit Printer B&E advanced 50 copë. Vendimi është marrë nga komisioni i marrjes në dorëzim.

Më datë 08.10.2021 me shkresën nr. 3183 Prot. OE "PS" ka dorëzuar pranë Universitetit Shkodër zërin nr. 27 të kontratës, printer për grafikë sipas specifikimeve teknike.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër i është drejtuar Gjykatës Administrative të shkallës së parë me kërkesë padi nr. 3207 Prot, datë 11.10.2021, për mos përmbushjen e kontratës, për të detyruar kontraktuesin “P.S” për të përmbushur kontratën. Procesi gjyqësor ndërmjet palëve nuk ka përfunduar akoma.

Me urdhrin e Administratorit nr. 3379 Prot. datë 25.10.2021 është kërkuar të mbahet ndalesë e faturës 3008/2021, në vlerën 906,747 Lekë si likuidim i dëmit mbi faturimin pas afatit të kontratës. Vlera totale e ndalesës si likuidim dëmi për faturim pas afatit të kontratës është 1,234,107 Lekë. Diferenca prej 237,360 Lekë sipas urdhrin do të mbahej nga pjesa e pa likuiduar e faturës me numër 1809/2021.

Me shkresën 2949/3 Prot. datë 25.11.2021 ka informuar Agjencinë e Prokurimit Publik mbi procedurën dhe problematikat e hasura në zbatimin e kontratës me OE “P.S”, shoqëruar me dokumentacionin përkatës për vlerësimin e situatës nga APP.

Me shkresën nr. 2949/4 Prot datë 20.12.2021 APP ka njoftuar Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër se deri në vendimin gjyqësor të formës së prerë në lidhje me këtë çështje nuk mund të vijojë me veprimet e mëtejshme administrative. APP ka kërkuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër që në përfundim të procesit gjyqësor, ti komunikojë vendimin e formës së prerë dhe dërgimin e kërkesës për përjashtimin e shoqërisë “P.C”, me qëllim procedimin konform legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Projektraportit të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 28.09.2022, protokolluar në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” me nr. 7670/3 datë 28.09.2022 mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione

2.3 Auditimi i Sigurisë së Informacionit

- a) Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet
- b) Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Mbi Auditimin e Sigurisë së Informacionit, në Universitetin e Shkodrës.

Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij.

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo vjen si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i asetëve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Bazuar në standardet ndërkombëtare, siguria e informacionit garantohet duke siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin

e incidenteve, aktiviteteve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme.

Procedura e backup-it

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Procedura e hartuar/e ndjekur nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në ndonjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e Universitetit.

Nga auditimi u konstatua se sistemi SMAK është i hostuar pranë ambienteve të AKSHI-t. Infrastruktura hardware dhe software janë të vendndodhura në datacenterin qeveritar dhe USH e përdor këtë sistem me anë të aksesit në distancë. Që nga momenti i implementimit të sistemit, ai është populluar me informacion dhe çdo gjë ruhet në serverin e sistemit të mundësuar nga AKSHI por që nuk është në pronësi të USH.

Edhe faqja web e USH <https://unishk.edu.al/> dhe portali i bibliotekës së USH www.bush.unishk.edu.al janë të hostuara në datacenterin qeveritar të AKSHI-t. Infrastruktura hardware dhe software janë të vendndodhura në datacenterin qeveritar dhe USH i përdor këto portale me anë të adresës web të lartpërmendur.

Që nga momenti i implementimit të sistemit, çdo gjë popullohet dhe ruhet në serverin e sistemit të mundësuar nga AKSHI por që nuk është në pronësi të USH. Pra hardware nuk është në pronësi të USH.

- Për sistemin SMAK bëhet backup manual në nivel database dhe file-ve duke e aksesuar me VPN. Transferimi i të dhënave në një makine tjetër bëhet manualisht.
- Backup i bazës së të dhënave të librave për sistemin e bibliotekës dixhitale bhet në mënyrë manuale;
- Backup për faqen e BUSH behet manual;
- Arkiva digjitale behen backup-e manualisht dhe ruhen në një HDD të jashtëm i cili ruhet në arkivin e bibliotekës;
- Backup për faqen e web unishk.edu.al behet manualisht njëherë në javë, si për file data ashtu edhe për databazën.

Nga auditimi u konstatua se:

- Procedurat e backup kryhen kryesisht manualisht;
- Procedurat e rikthimit (restore) të të dhënave nuk testohen për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar për sistemet e sipërpërmendura;
- Ruajtja e backup në vende në distancë nuk realizohet;
- Pajisjet e rrjetit (*switch dhe router*) nuk janë bërë backup;
- Në rastet kur të dhënat e backup-it janë të panevojshme nuk ekzistojnë procedura për mënyrën e nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit;
- Nuk është e qartë nëse kontrollohet statusi i backup-it nëse procedura është kryer me sukses.

Active Directory

Nga auditimi i sigurisë së të dhënave që USH administron në sistemin e saj rezulton se: Siguria e rrjetit të USH është e kompromentuar pasi nuk ka Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qendëruar dhe të sigurtë. Pa Active Directory, çdo kompjuter në rrjet ka bazën e të dhënave të veta të vogla të emrave të përdoruesve dhe fjalëkalimeve. Microsoft e

quan këtë lloj krijimi një GRUP PUNE (WORKGROUP), domethënë çdo kompjuter vepron më vete dhe nuk ka kontroll qendror. Ky lloj konfigurimi krijon një sfidë kur kemi shumë kompjutera dhe një përdorues duhet të ketë qasje në njërin prej tyre ose kur ai ndryshon fjalëkalimin ose emrin e përdoruesit. Active Directory mban në një memorie të centralizuar, emrat, përdoruesit dhe fjalëkalimet. Çdo ndryshim në emrat e përdoruesit dhe fjalëkalimet regjistrohen nga Active Directory dhe të gjithë kompjuterat në rrjet kanë qasje në këtë informacion. Prandaj Active Directory:

- Është një bazë të dhënash;
- Siguron kontroll të centralizuar;
- Regjistron të gjitha ndryshimet e fjalëkalimeve;
- Mund të shpërndahet në të gjithë botën;
- Ruan burimet në share folders
- Shërbimet si email mund të përdorin Active Directory.

Administratorët e rrjetit e përdorin Active Directory për të ruajtur dhe organizuar objekte në një rrjet (të tilla si përdoruesit, kompjuterët, pajisjet, etj.) Në një strukturë të sigurt hierarkike të kontrollit që njihet si strukturë logjike.

Nga administrimi i dokumentacionit u konstatua se USH për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet nuk ka ngritur Active Directory.

Ngritja e një Active Directory për USH do të thotë, krijim dhe logimin e përdoruesve të administratës së UV dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “*single sign in*”. Përdoruesit mund të logohen me adresën e emailit në pc, në email, në rrjet e etj me anë të domain controller-it duke patur një autentifikim të sigurt. Me anë të “*single sign in*” përdoruesit mund të logojnë:

- në PC;
- në network (wifi me pajisjet, laptop, smartphone, tablet, etj);
- në email;
- në apps;
- etj.

Duke krijuar usera manualisht, konfigurimin e emaileve për çdo user në mënyrë manuale dhe ruajtjen e të dhënave të përdoruesve në pc e tyre pa kontroll të qendëruar rrezikon kompromentimin e sigurisë së infrastrukturës network në USH.

Konkluzion:

Nga administrimi i dokumentacionit u konstatua se USH, nuk ka ngritur Active Directory për menaxhimin e userave, pajisjeve, aplikacioneve dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “*single sign in*” për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet me të mira. Në opinionin e grupit të auditimit përdorimi i një zgjidhje të tillë do të sillte lehtësira për stafin e USH në procesin e punës si dhe rritjen e sigurisë së të dhënave.

Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat.

Qëllimi i menaxhimit të vazhdimësisë, është të mirëmbahen kërkesat e vazhdimësisë së institucionit. Menaxhimi i vazhdimësisë përfshin rishikimin periodik dhe azhurnimin e afatit të rimëkëmbjes për të siguruar që ato janë në përputhje me Planet e Vazhdimësisë së Biznesit. Vazhdueshmëria a biznesit (BCP) është procesi që një institucion ndjek për të planifikuar dhe testuar rimëkëmbjen e operimit të saj pas një ndërprerjeje.

Auditimi mbi ofrimin e Vazhdimësisë së ofrimin të shërbimeve, u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar, risqeve të

identifikuara dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je: “Çdo institucion i cili ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbimit të informacionit për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave”. Në këtë VKM cilësohet gjithashtu edhe dokumentimi i politikave mbi planin e vazhdueshmërisë së punës dhe rikuperimit nga katastrofat, si dhe të bëhet i mundur evidentimi i sistemeve të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24/7. Gjatë periudhës së zhvillimit të auditimit në terren, datacenteri qeveritar dhe shërbimet qeveritare online u sulmuan nga një sulm kibernetik i cili paralizoi të gjitha shërbimet online. Duke qenë se sistemi SMAK dhe faqja e web janë të hostuara në datacenterin qeveritar tek AKSHI, gjatë kësaj periudhe edhe këto sisteme u ndikuan nga ky sulm duke ndërprerë shërbimin.

Universiteti i Shkodrës, si institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor që posedon sistemin SMAK (*Sistemi i menaxhimit akademik*), që ruan, përpunon dhe gjeneron të dhëna me rëndësi për menaxhimin dhe organizimin e procesit dhe kontrollin e mësimdhënies si dhe procesin e pranimit, regjistrimit dhe ofrimit të shërbimeve për studentët, nuk ka marrë masa sa më poshtë.

Nga auditimi u konstatua se, USH :

- Nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

Kontrollet e aksesit politikat e aksesit menaxhimi i privilegjeve përdorimi i TI në krijimin e kushteve fizike në USH.

Posedimi i kontrollit të aksesit është i rëndësishëm kur personat kërkojnë në informacion ose pajisje të rëndësishme, konfidenciale ose sensitive. Në një mjedis shtetëror, kontrolli i aksesit është i rëndësishëm sepse shumë subjekte publike përpunojnë të dhëna sensitive dhe çështjet e privatësisë limitojnë se cilët persona duhet të shohin pjesë të ndryshme të informacioni.

Politikat e aksesit japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve të institucionit. Funkzioni i Sigurisë së Informacionit monitoron efektivitetin e kontrollit të operacioneve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve në kohë dhe raporton efikasitetin dhe efektivitetin e operimit.

Nga auditimi u konstatua se hyrja kryesore e Rektoratit të USH nuk është e kontrolluar nga një sistem të veçantë aksesit, hyrje daljet të punonjësve të USH nuk ruhen dhe nuk monitorohen pasi nuk kanë të instaluar një sistem aksesit të hyrje-daljeve duke kompromentuar nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.

Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë

mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve. Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Duke mos realizuar identifikimin e risqeve, universiteti rrezikon që risqet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës së sistemeve, ndërprerjen e shërbimeve etj. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që universiteti të mos identifikojë risqet me efekt negativ në IT dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim dhe mos lënie gjurmësh për trajtimin e gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e IT.

-Menaxhimi i ndryshimeve.

Nga auditimi u konstatua se USH nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për kryerjen e ndryshimeve.

b. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Auditimit mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Duke qenë se dhoma e serverëve është pika më delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të IT në USH, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në katin e parë të Rektoratit ku është hostuar rack-u me serverat e sistemit të menaxhimit të shkresave.

Nga auditimi u konstatua se:

Ambienti fizik i dhomës së serverëve ku është hostuar serveri i sistemit të menaxhimit të shkresave dhe disa pajisje të tjera nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (*Versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI (*Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit*), përkatësisht:

Nga auditimi i kushteve dhe karakteristikave teknike të ndërtimit të dhomës së serverit u konstatua se:



Ambienti ku janë vendosur serverat dhe pajisjet e network, switch dhe routera është një zyrë e përshtatur si dhomë serverash, duke mos plotësuar kushtet minimale teknike për tu klasifikuar si një dhomë serverash.

a. Muret e dhomës së serverëve dhe nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluara nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);

b. Dhoma nuk përbëhet nga një dysHEME teknologjike në të cilën të jetë e parashikuar pesha e rack-eve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen në të dhe nuk ka pendence në drejtim të derës së dhomës së serverëve;

c. Dhoma e serverëve nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;

- d. Dhoma e serverëve nuk përmban kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës. Ftohja e dhomës realizohet me anë të kondicionerit të thjeshtë;
 - e. Dhoma e serverëve nuk plotëson kushtet teknike lidhur me kapacitetin dhe cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
 - f. Në dhomën e serverëve mungon sistemi i alarmit dhe hyrja në dhomë nuk është e siguar me anë të një sistemi elektronik dhe sistem alarmi në rast thyerje të saj; në kundërshtim me pikën 4.1, 4.3, 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve.
 - g. Nga auditimi i pajisjeve të cilat janë vendosur në dhomën e serverit rezultoi se rack-u i vendosur nuk është i mbrojtur kundër lëkundjeve sizmike, nuk ka hapësirë përpara apo anash tij sipas përcaktimeve të prodhuesit, në kundërshtim me pikën 4.2 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve.
 - h. Nga auditimi i procedurës së administrimit të dhomës së serverëve konstatohet se në kundërshtim me pikën 6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve nuk është e rregulluar me një procedurë të miratuar duke kompromentuar sigurinë e saj me hyrje-dalje të personave të paautorizuar. Nuk ka një procedurë të shkruar në rast të marrjes në përdorim të çelësit të dhomës së serverëve nga stafi i TI-së dhe ruajtjes së tij në rastet e emergjencës.
 - i. Konstatohet se në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen edhe materiale të tjera (dosje, dollap, karrige) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj.
 - j. Hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve monitorohet vetëm nga kamerat e korridoreve të rektoratit.
- Foto nga ambienti fizik i dhomës së serverëve*




Auditimi mbi pajisjet router dhe infrastruktura e networkut

Referuar pikave kryesore të sigurisë së informacionit në rrjetin privat dhe publik janë verifikuar onsite infrastruktura network e institucionit. Komunikimi me fakultetet, realizohet me fibër optike. USH ka ngritur një infrastrukturë të zgjeruar network në qendër e në fakultete.

Topologjia e infrastrukturës së ndërtuar Hardware/Software/Network:

Topologjia e networkut është e tipit yll (star) network, përbëhet nga kompjutera për përdorim personal dhe rrjeti i brendshëm kompjuterik, nëpërmjet të cilit aksesohet interneti dhe printerat e institucionit. Me anë të këtij rrjeti aksesohen shërbimet e tjera on-line që ofrohen për USH. USH ka ngritur gjithashtu një rrjet wifi me access point në godinën e rektoratit dhe nëpër godinat e fakulteteve. Pajisjet e tipit Grandstream janë instaluar dhe konfiguruar nga OE.

Foto të switch-eve të instaluar në godinat e fakulteteve:



Nga auditimi u konstatua:

Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në USH mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar. Shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektiven e zhvillimeve të përcaktuara.

1. Titulli i gjetjes: Siguria e rrjetit të USH është e kompromentuar pasi nuk ka Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qendërzuar dhe sigurt.

Situata: Nga auditimi u konstatua se USH, nuk ka ngritur Active Directory për menaxhimin e userave, pajisjeve, aplikacioneve dhe marrjen e

	shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “ <i>single sign in</i> ” për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimit të shërbimeve në përputhje me standardet me të mira.
Kriteri:	Politikat e sigurisë së informacionit mbulojnë të gjithë risqet operacionale dhe ka mundësi të mbrojtë në mënyrë të arsyeshme të gjithë asetet e informacioneve kritike kundrejt humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit. Politikat e sigurisë së informacionit janë të afta të mbrojnë të gjithë informacionin konfidencial lidhur me palët e brendshme dhe të jashtme detyra dhe përgjegjësi të qarta të IT lidhur me Politikën e Sigurisë së Informacionit (referuar ISO 27000).
Ndikimi/Efekti:	Risk i mos përmbushjes së veprimtarisë institucionale, humbje të informacionit.
Shkaku:	Mos zbatim praktikave më të mira (Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit).
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Universiteti i Shkodrës të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një Active Directory me qëllim standardizimin e infrastrukturës IT, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe garantimin e një identifikimi të qendërzuar dhe të sigurt.

2.Titulli i gjetjes:	Planet e vazhdimësisë së punës dhe procedurat e backup.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se: - USH nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar. - Procedurat e backup kryhen kryesisht manualisht; - Procedurat e rikthimit (restore) të të dhënave nuk testohen për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar për sistemet e sipërpërmendura; - Pajisjet e rrjetit (<i>switch dhe router</i>) nuk janë bërë backup; - Në rastet kur të dhënat e backup-it janë të panevojshme nuk ekzistojnë procedura për mënyrën e nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit; - Nuk është e qartë nëse kontrollohet statusi i backup-it nëse procedura është kryer me sukses.
Kriteri:	VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar, dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare (<i>COBIT dhe Manuali i Auditimit IT</i>).
Ndikimi/efekti:	Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.
Shkaku:	Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese në Universitetin e Shkodrës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për

sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

- 3.Titulli i gjetjes:** Mungesa e monitorimit të hyrje - daljeve me anë të sistemeve elektronike, në ambientet fizike të Rektoratit
- Situata:** Nga auditimi u konstatua se hyrja kryesore e Rektoratit të USH nuk është e kontrolluar nga një sistem të veçantë aksesi, hyrje daljet të punonjësve të USH nuk ruhen dhe nuk monitorohen pasi nuk kanë të instaluar një sistem aksesi të hyrje-daljeve duke kompromentuar nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.
- Kriteri:** Sigurimi se masat organizative dhe fizike garantojnë parandalimin e aksesit të paautorizuar.
- Ndikim/Efekti:** Risk për akses të pa autorizuar.
- Shkaku:** Nuk janë marrë masat e nevojshme administrative për akses të sigurt duke mos zbatuar praktikat më të mira.
- Rëndësia:** E lartë.
- Rekomandimi:** USH të analizojë nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e rektoratit dhe marrjen e masave shtesë në qoftë se e gjykon të arsyeshme, me qëllim kufizimin e aksesit të personave të paautorizuar që nuk janë pjesë e administratës por edhe për të administruar hyrje daljet e stafit të administratës së rektoratit.

- 4.Titulli i gjetjes:** Mos menaxhim i incidenteve dhe ndryshimeve, dhe mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.
- Situata:** Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Shkodrës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.
- Ndikimi/efekti:** Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.
- Shkaku:** Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
- Rëndësia:** : E lartë
- Rekomandimi:** Strukturat Drejtuese në Universitetin e Shkodrës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

- 5. Titulli i gjetjes:** Dhoma e serverave dhe infrastruktura network nuk plotësojnë standardet e përcaktuara dhe mbështeten në një infrastrukturë IT (rrjeti network) të amortizuar.
- Situata:** -Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve në Universitetin e Shkodrës nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.
-Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në USH mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar. Shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektiven e zhvillimeve të përcaktuara.
- Kriteri:** Garantimi i sigurisë fizike dhe ambientale është në përputhje me kërkesat për siguri dhe me klasifikimin e sensitivitetit të aseteve IT. Garantimi se ndërhyrjet zbulohen dhe trajtohen (Politika të brendshme të sigurisë).
Rregulloren e miratuar nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve” (versioni 1.0, datë 02.12.2008)
- Ndikimi/efekti:** Cënim i sigurisë, hyrje e paautorizuara dhe risk humbje të të dhënave
- Shkaku:** Mungesa e investime në infrastrukturë dhe mos zbatim i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Universiteti i Shkodrës të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një infrastrukturë IT (ambienteve të dhomës të serverëve dhe rrjetin network) në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Auditimi i Sistemeve

a. Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi Universiteti i Shkodrës ka pasur dhe ka në përdorim sistemet si më poshtë:

1. Sistemi PITAGORA. Universiteti i Shkodrës për administrimin e aplikimit universitar përdor sistemin Pitagora, të ofruar nga RASH dhe është vendosur në funksion në vitin 2022, një sistem i përditësuar nga versioni i mëparshëm ESSE 3.

Ky aplikacion software i sekretarisë online është zhvilluar nga RASH¹, i cili ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe përdoruesit fundor të cilët janë studentë, pedagogë, etj., për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare si: regjistrimi në silabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj.

Sistemi PITAGORA, shërben gjithashtu edhe për menaxhimin e notave të studentëve nga ku studentët mund të shohin notat, grafikun e provimeve dhe të riprovimeve, prenotimet online të provimeve dhe riprovimeve si dhe pagesat.

¹ Rrjeti Akademik Shqiptar

Disa nga funksionalitetet kryesore të sistemit PITAGORA janë:

- Krijo orar;
- Lëndët;
- Pedagogët;
- Përdoruesit;
- Programe;
- Studentët.

Hapësira didaktike - e cila përmban strukturat akademike, menaxhimin e karrierës së studentit, provime dhe tema e diplomës.

Hapësira administrative - e cila përmban pranimin dhe regjistrimin, orarin dhe provimet si dhe menaxhimin e studentëve.

Tarifat - për menaxhimin e tarifave të studimit, bursat për studentët, periudhat financiare.

Diplomimi - i cili përmban provimet e shtetit, praktika studentore, diploma online dhe suplementi.

Gjeneralitetet e studentëve dhe stafit akademik dhe jo akademik realizohen nëpërmjet një formulari që plotësohet nga vetë studenti të cilat ruhen pranë sekretarive, ndërsa për pedagogët dhe administratën të dhënat merren nga burimet njerëzore. Sistemi PITAGORA nuk merr ose jep të dhëna nga institucionet tjera. Të dhënat që merren nga sistemi PITAGORA janë përgjegjësi e RASH.

2. Office 365 - Microsoft Teams – janë dy platforma të Microsoft të cilat përdoren nga stafi i USH. Stafi akademik dhe administrativ si dhe studentet përdorin paketën Office 365 nëpërmjet email-it zyrtar të USH dhe realizohet menaxhimi i adresave zyrtare të USH, ndërsa nëpërmjet aplikacionit Microsoft Teams zhvillohet mësimi online.

3. Sistemi U-ALBANIA - lindi si nevojë për sekretarinë dhe IT për regjistrimin e studenteve, për shkarkimin e listave të aplikantëve në universitet si dhe ngarkimi i listave të renditura në bazë të fituesve.

4. Sistemi i Menaxhimit të shkresave - Sistemi për shkresat, diplomat, burimet njerëzore është zhvilluar nga specialistet e TIK në USH. Ky sistem është ndërtuar bazuar në një zgjidhje open source.

5. Sistemi SMAK – (Sistemi i menaxhimit akademik). Sistemi SMAK përdoret për plotësimin e planeve mësimore, ngarkesave dhe evidencave të pedagogëve të USH. Ky sistem është implementuar në vitin 2018 dhe i shërben stafit akademik, drejtorisë së financës, kurrikulës dhe auditit.

Nga auditimi i sistemeve të cilat u vlerësuan si më të rëndësishme:

I. *Sistemi i Menaxhimit të shkresave.* Shkresat janë komunikime fakultet-ректорat dhe anasjelltas, dhe shkresat nga jashtë universitetit drejt rektoratit. Burimet njerëzore janë pedagoge të brendshëm dhe të jashtëm, gradat, datat kur ka filluar. Diplomat janë tekst me të dhëna emër + mbiemër dhe dokumenti i skanuar, me të dhëna të dy viteve të fundit. Ky sistem funksionon si një arkiv dixhitale. Sistemi i menaxhimit të shkresave ka ardhur si nevojë e brendshme personelit që punon në USH për të marrë shkresat. Secili përdorues ka kredencialet e veta me të cilat logohet në sistem.

Ky aplikacion është ndërtuar si një kontribut nga specialistët e Sektorit TIK zhvilluar mbi burime të hapura të kodimit (open source), për të cilin USH nuk ka paguar asnjë kosto zhvillimi. Ky sistem funksionon si një arkivë dixhitale, ku në të popullohen të gjitha shkresat zyrtare në formatin pdf. Nga ky sistem nuk gjenerohen dokumente zyrtare.

Sistemi i menaxhimit të shkresave është i ndarë në module të cilat kategorizohen si më poshtë:

-Moduli i shkresave - është një modul për menaxhimin e shkresave në rang Universiteti.

-Moduli i Burimeve Njerëzore - moduli i burimeve njerëzore është një modul në të cilin punojnë personat tek burimet njerëzore, aty hidhen të gjitha të dhënat e personelit akademik dhe jo

akademik. Sistemi lindi si nevojë pasqyrimin të të gjitha të dhënave në një faqe web të cilat mund të menaxhohen më mirë si dhe në çdo rast kërkimi i personave bëhet me i thjeshtë.

-Moduli i Diplomave - moduli i diplomave u mbështet në vendimin e rektoratit me nr.1283 prot., datë 13.04.2021., për ruajtjen e përhershme të një kopjeje të digjitalizuar të diplomave të lëshuara nga universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Ky sistem nuk ndërvepron me sisteme të tjera në asnjë prej moduleve të tij.

Nuk disponohet manual administratori dhe manual përdoruesi. Të drejtat administrative në këtë aplikacion janë: *krijim përdoruesish, role, dhe përshtatje programi sipas kërkesave.*

Në këtë aplikacion të gjitha të dhënat mund të ndryshohen pasi janë ruajtur. Këto ndryshime mund t'i bëjnë përdoruesit e sistemit sipas moduleve, ndërsa autorizimin e veprimeve e kryen Krye sekretarja mësimore , sekretarja e rektorit, Burimet njerëzore.

Administratori i sistemit i monitoron dhe administron log-s, megjithëse *nuk disponojnë asnjë akt rregullator mbi ruajtjen dhe administrimin e tyre.*

II. Sistemi SMAK. Përdoruesit në këtë sistem krijohen nga Specialistët e IT. Planet mësimore regjistrohen nga përgjegjësi i departamentit dhe kontrolli automatik i implementuar kryhet mbi numrin maksimal të krediteve dhe ngarkesës javore. Nuk lejon printimin e planit nëse kalohet kufiri për numrin total të krediteve apo të ngarkesës javore.

Evidencat mësimore nuk lejon krijimin e më shumë se një formulari për një vit akademik. Jep mesazh informues që ka një formular për këtë vit akademik.

Sistemi SMAK është një soft i orientuar nga pedagogu, ndërsa Pitagora i orientuar me shumë nga studentët.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar u konstatua se:

- Ky sistem është mirëmbajtur për një vit, ndërsa aktualisht është pa mirëmbajtje. Për problemet e ndryshme të dalë gjatë punës mbi këtë sistem kanë dhënë suportin e tyre specialistët e IT-së por zgjidhjet kanë qenë pjesore, duke rritur riskun e ndërprerjes së shërbimit dhe sigurinë e të dhënave.

- Manuali i përdoruesit për këtë sistem është hartuar nga specialistët e IT, ndërsa manual të administrimit nuk ka.

- Dokumentet e gjeneruara nga ky sistem akoma nuk janë të zyrtarizuara me një vendim senati apo Rektori;

- Ndërveprime me këtë sistem nuk janë ndërtuar .

Raportet e ndërtuara në sistemin SMAK janë në nivel fakulteti apo departamenti. Raportet gjenerohen dhe për ngarkesat e pedagogëve dhe evidencat e tyre. Këto raportime përdoren nga stafi akademik, kurrikula, financa dhe auditit.

Në këtë sistem mund të ndryshohen të gjitha të dhënat përveç log-eve të ruajtura në data bazë. Ndryshimet kryhen nga përdoruesit e sistemit ndërsa autorizimi i veprimeve kryhet sipas hierarkisë ku stafi akademik dhe burimet njerëzore autorizojnë ndryshimet në sistem.

Nga auditimi u konstatua se disa funksionalitete të SMAK nuk është e mundur të hidhen në Pitagora si: formulari financiar, evidencat e orëve të realizuara si dhe orëve jashtë orarit. Ndërkohë që në Pitagora ka funksionalitete më shumë të orientuara nga studentët.

Në SMAK janë ngarkesat, evidencat, marrëveshja 1536 orë-she për pedagogun dhe gjenerimi i llogaritjeve në PDF.

Nga auditimi u konstatua se:

- Të dhënat e pedagogëve janë në modulin e burimeve njerëzore të sistemit të shkresave, por dhe tek Pitagora, por në sistemin e brendshëm ka më shumë fusha ku mund të plotësohen të dhëna mbi edukimin e pedagogut si bachelor, masterin apo titulli që ka marrë, datën në të cilën e ka marrë, institucionin, vitin e diplomimit etj.

- Planet mësimore gjenden në SMAK dhe në Pitagorë por në SMAK ka më shumë fusha ku mund të plotësohen të dhëna si:
 - Leksione, seminare, laboratorë, praktika për javë mësimi të ndara sipas semestrave;
 - Totali i leksioneve, totali i seminareve, totali i laboratorëve, totali i praktikave për javë mësimi si dhe për vit akademik;
 - Orët jashtë auditorit;
 - Tipi (provim apo firme);
 - Përqindja e krediteve sipas tipit të veprimtarisë (A,B,C,D,E,F);
 - Gjenerimi i PDF për planin mësimor;
 - USh nuk disponon akte rregullatore për menaxhimin e log-eve digjitale.

Pra, punonjësit janë detyruar të punojnë në dy sisteme për të dhëna specifike duke i regjistruar ato manualisht në Pitagora dhe në SMAK, sepse të dhënat në Pitagora orientohen për studentët, ndërsa të dhënat në SMAK plotësojnë më mirë kërkesat e stafit akademik, ndihmës akademik si dhe administrativ.

USh e përfaqësuar nga rektori, ka nënshkruar krijimin e Rrjetit Akademik Shqiptar - RASH dhe me anë të shkresës nr.3623 prot., datë 14.11.2017, ka vendosur të jetë pjesë e marrëveshjes me nr.88, datë 14.02.2018 për “Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”.

Konform pikës 3/ç dhe 4/a, qëllimi i RASH:

- 3/ç: Është zhvillimi i programeve software dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta.
- 4/a: Kryen zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar.

Të dhënat që USh ruan në sistemin Pitagora janë:

- Të dhënat personale të studenteve;
- Programet e studimit;
- Grafiku i provimeve;
- Notat e provimeve.

Raportet që gjeneron USh janë raporte për të dhënat e studentëve. Shumë veprime të tjera që i përkasin administrimit universitar apo proceseve akademiko-shkencore mbeten jashtë sistemit për arsye se nuk ju përshtaten kërkesave të universiteteve.

Pra, të dhënat që ruhen dhe veprimet që kryhen në sistemin Pitagora janë bazike, që do të thotë se ajo që ofrohet nuk plotëson kërkesat e universiteteve.

Nisur sa më sipër Universiteti i Shkodrës kryen veprime operacionale të pjesshme në sisteme informatike minimaliste për nga funksionalitetet si dhe kostot. Sistemi i vënë në funksion Pitagora nuk plotëson kërkesat e universiteteve, çfarë ka sjellë dhe popullim minimal të të dhënave në këtë sistem si dhe nevojën për të zhvilluar sisteme të brendshme për një menaxhim më të mirë të të dhënave.

1. Titulli i gjetjes:	Funksione minimaliste ndërtuar në disa sisteme, veprime operacionale të përdoruesve që përsëriten.
Situata:	Universiteti i Shkodrës kryen veprime operacionale të pjesshme në sisteme informatike minimaliste për nga funksionalitetet si dhe kostot. Punonjësit punojnë në dy sisteme, për të dhëna specifike duke i regjistruar ato manualisht në Pitagora dhe në SMAK, sepse të dhënat në Pitagora orientohen për nga studentët, ndërsa të dhënat në SMAK plotësojnë më mirë kërkesat e stafit akademik, ndihmës akademik si dhe administrativ.
Situata:	Disa funksionalitete të SMAK nuk është e mundur të hidhen në Pitagora si: formulari financiar, evidencat e orëve të realizuara si dhe orëve jashtë orarit.
Situata:	Raportet që gjeneron USh nga sistemi Pitagora janë raporte për të dhënat e studentëve. Shumë veprime të tjera që i përkasin administrimit universitar apo proceseve akademiko-shkencore mbeten jashtë sistemit për arsye se nuk ju përshtaten kërkesave të universiteteve.
Situata:	Të dhënat e pedagogëve janë në modulin e burimeve njerëzore të sistemit të shkresave, por dhe tek Pitagora, por në sistemin e brendshëm ka më shumë fusha ku mund të plotësohen të dhëna mbi edukimin e pedagogut si bachelor, masterin apo titulli që ka marrë, datën në të cilën e ka marrë, institucionin, vitin e diplomimit etj. Planet mësimore gjenden në SMAK dhe në Pitagorë, por në SMAK ka më shumë fusha ku mund të plotësohen të dhëna.
Kriteri:	Input / Output i të dhënave në sistem.
Shkaku:	Ndikimi/efekti: Të dhëna të përsëritura, veprime manuale të dubluara
Rëndësia:	Mungesa e investimeve në sisteme informatike.
Rekomandimi:	E lartë
Rekomandimi:	Universiteti i Shkodrës, të analizojë dhe vlerësojë të gjitha mundësitë që informatizimet e pjesshme që ndihmojnë aktivitetin administrativ të universitetit t'i përmbledhë në një sistem informatik të vetëm, çfarë do të lehtësonte mirëmbajtjen dhe suportin nga punonjësit e sektorit IT, por dhe përdoruesit të cilët do të gjenin çdo informacion të nevojshëm brenda një sistemi.
Rekomandimi:	Universiteti i Shkodrës, të adresojë në institucionet përgjegjëse çështjet që nuk janë në kompetencën e tij, por rrezikojnë përdorimin apo të dhënat në sistemin Pitagora, në mënyrë që të nxiten të gjithë faktorët për krijimin e kushteve optimale në popullimin dhe sigurimin e të dhënave në këtë sistem të ndërtuar për studentët në vend.

b. Kontrolli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre

Përdoruesit e Sistemit SMAK. Në këtë sistem janë afërsisht 253 përdorues. Në këtë numër përdoruesish bëjnë pjesë punonjës të USh të ndara sipas roleve si më poshtë:

- Admin (1 përdorues);
- Dekan (6 përdorues);
- Financa (1 përdorues);
- Kordinator (6 përdorues);
- Kurrikula (1 përdorues);

- Pedagog (211 përdorues);
- Burimet Njerëzore (1 përdorues);
- Planet_Web (1 përdorues);
- Rektor (2 përdorues);
- Shef Departamenti (21 përdorues);
- Auditi

Në sistemin e menaxhimit të shkresave punojnë këta përdorues:

Moduli shkresat - administratori, rektori, zv. rektori, drejtorja e IT, ekonomistët, sekretarët e dekanëve, arkiva, protokolli, kurrikula, marrëdhëniet me jashtë, zyra e prokurimeve, kryesekretarja.

Moduli Diplomati – administratori, kryesekretarja, sekretaritë mësimore.

Moduli Burimet Njerëzore – administratori dhe burimet njerëzore.

Në këtë sistem janë 29 përdorues nga të cilët 7 përdorues me kredenciale të përgjithshme. Grupet e përdoruesve janë si në vijim: admin_group, administrator_group, biblioteka_group, burimetnjerëzore_group, ekonomiku_group, sekretare_group, fdr_group, fe_group, fgjh_group, fshe_group, fshn_group, fshsh_group, it_group, kryesekretare, kurrikula_group, mjashte_group, prokurimet_group, protokolli_group, rektor_group.

Ka përdorues për të cilët atributi “username” me të cilin përdoruesi logohet dhe atributi “user” janë si përdorues aktiv në sistem me kredenciale të përgjithshme të cilët nuk janë përcaktuar se nga cili punonjës posedohen dhe përdoren. Ky fakt mbart një risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem duke mos lënë gjurmë mbi aktivitetin që kanë kryer.

- 1. Titulli i gjetjes:** Përdorues të krijuar pa një standard, administrohen pa akt rregullativ.
- Situata:** Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemeve informatike në USH, u konstatua se:
- Nuk ka një udhëzues për sa i përket fjalëkalimeve, si ndryshimet në password, periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit.
 - Për periudhën nën auditim, nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve në të cilin të përcaktohen qartë procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e përdoruesve. Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email.
 - Nuk ka një manual për administratorin e sistemit.
- Situata:** Nga verifikimi në nivel administrativ që grupi i auditimit kreu në sistem lidhur me krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesit, rezultoi se nuk është ndjekur i njëjti standard në krijimin e përdoruesit:
- Në një rast është krijuar sipas modelit emër MBIEMËR;
 - Në disa raste janë krijuar sipas modelit emër (Mbiemër) MBIEMËR;
 - Në disa raste sipas modelit emër MBIEMËR (Mbiemër).
- Kriteri:** Eksperienca me të mira, gjurma e auditimit.
- Ndikimi/efekti** : Mungesa e gjurmës audituese në lidhje me veprimet e përdoruesit, risk për ndërhyrje të paautorizuara në sistem pasi nuk identifikohet saktësisht përdoruesi që ka kryer një aktivitet të caktuar.
- Shkaku:** Mungesa e akteve rregullative si dhe një standardi të miratuar për përdoruesit.
- Rëndësia:** E lartë

- Rekomandimi:** Universiteti i Shkodrës të identifikojë dhe të miratojë një standard dhe akt rregullativë mbi menaxhimin e përdoruesve si një mjet i domosdoshëm i cili garanton gjurmën e veprimeve të përdoruesve dhe ofron një identifikim më të sigurt në sistemet informatike.
- Rekomandimi:** Sektori i IT në Universitetin e Shkodrës, në bazë të rregullores së miratuar për përdoruesit dhe standardit të aprovuar për identifikimin e përdoruesit, të bëjë korrigjimet e nevojshme në emërtimin e përdoruesve

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se:

- Universiteti i Shkodrës nuk ka një plan strategjik të shkruar e miratuar për teknologjinë e informacionit duke mos bërë planifikime strategjike mbi sigurinë institucionale dhe infrastrukturën IT si dhe duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e planifikimeve strategjike institucionale mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së USH-së.

- Institucioni vepron bazuar në një rregullore të brendshme version i pa update-uar me ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në universitet, gjithashtu në këtë rregullore nuk janë të përfshira detyrat aktuale që drejtoria IT kryen.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, të marrë masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit, si dhe të marrë masa për përcaktimin e elementëve dhe indikatorëve të matshëm për matjen e plotësisht të objektivave të përcaktuara.

1.2. Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën të pasqyrohen dhe reflektohen qartë detyrat operacionale në lidhje me ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike.

Menjëherë

2. Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se:

- Në Universitetin e Shkodrës përshkrimet e punës për stafin e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit mbi mënyrën, organizimin, funksionimin dhe ndarjen e përgjegjësive specifike të roleve, punëve dhe veprimeve operacionale brenda drejtorisë, nuk janë të miratuara por i janë paraqitur grupit të auditimit si Relacionin drejtuar Rektorit të Universitetit me nr. 2657 prot., datë 08.10.2020.

- Përshkrimet e punës nuk janë të përfshira në rregulloren e brendshme të Universitetit të Shkodrës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme institucionale në të cilën të pasqyrohen dhe reflektohen qartë detyrat operacionale. Gjithashtu, të marren masa dhe për përfshirjen e detyrave funksionale të punonjësve në rregulloren e brendshme.

Menjëherë

3.Titulli i gjetjes: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Universiteti i Shkodrës, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2020 - 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Kjo në kundërshtim me rregulloren e brendshme në të cilën përcaktohet se Burimet Njerëzore të cilat bëjnë identifikimin e nevojave për trajnim të personelit, harton dhe zbaton programe trajnimi të veçanta në përputhje me nevojat e institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit i cili merret me administrimin e bazës së të dhënave dhe të çdo përdoruesi të sistemit, si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Shkodrës nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ për sa i përket arritjes së objektivave institucionale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” të marrë masa hartimin e regjistrit të riskut ku të përfshihen edhe risqet për Teknologjinë e Informacionit me qëllim identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin / parandalimin e risqeve të identifikuar, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se USH, nuk ka ngritur Active Directory për menaxhimin e userave, pajisjeve, aplikacioneve dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “single sign in” për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet me të mira.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një Active Directory me qëllim standardizimin e infrastrukturës IT, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe garantimin e një identifikimi të qendëruar dhe të sigurt.

Në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- USH nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar.

- Procedurat e backup kryhen kryesisht manualisht;

- Procedurat e rikthimit (restore) të të dhënave nuk testohen për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që ato mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar për sistemet e sipërpërmendura;

- Pajisjet e rrjetit (switch dhe router) nuk janë bërë backup;

- Në rastet kur të dhënat e backup-it janë të panevojshme nuk ekzistojnë procedura për mënyrën e nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit;

- Nuk është e qartë nëse kontrollohet statusi i backup-it nëse procedura është kryer me sukses.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Universitetin e Shkodrës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se hyrja kryesore e Rektoratit të USH nuk është e kontrolluar nga një sistem të veçantë aksesi, hyrje daljet të punonjësve të USH nuk ruhen dhe nuk monitorohen pasi nuk kanë të instaluar një sistem aksesi të hyrje-daljeve duke kompromentuar nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: USH të analizojë nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e rektoratit dhe marrjen e masave shtesë në qoftë se e gjykon të arsyeshme, me qëllim kufizimin e aksesit të personave të paautorizuar që nuk janë pjesë e administratës por edhe për të administruar hyrje daljet e stafit të administratës së rektoratit.

Në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Shkodrës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Universitetin e Shkodrës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve në Universitetin e Shkodrës nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

-Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në USH mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar. Shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektiven e zhvillimeve të përcaktuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një infrastrukturë IT (ambienteve të dhomës të serverëve dhe rrjetin network) në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në vijimësi

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 19-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.Gjetje nga auditimi: Universiteti i Shkodrës kryen veprime operacionale të pjesshme në sisteme informatike minimaliste për nga funksionalitetet si dhe kostot. Punonjësit operojnë në

dy sisteme, për të dhëna specifike duke i regjistruar ato manualisht në Pitagora dhe në SMAK, sepse të dhënat në Pitagora orientohen për nga studentët, ndërsa të dhënat në SMAK plotësojnë më mirë kërkesat e stafit akademik, ndihmës akademik si dhe administrativ.

- Disa funksionalitete të SMAK nuk është e mundur të hidhen në Pitagora si: formulari financiar, evidencat e orëve të realizuara si dhe orëve jashtë orarit.

- Raportet që gjeneron USh nga sistemi Pitagora janë raporte për të dhënat e studentëve. Shumë veprime të tjera që i përkasin administrimit universitar apo proceseve akademiko-shkencore mbeten jashtë sistemit për arsye se nuk ju përshtaten kërkesave të universiteteve.

- Të dhënat e pedagogëve janë në modulën e burimeve njerëzore të sistemit të shkresave, por dhe tek Pitagora, por në sistemin e brendshëm ka më shumë fusha ku mund të plotësohen të dhëna mbi edukimin e pedagogut si bachelor, masterin apo titulli që ka marrë, datën në të cilën e ka marrë, institucionin, vitin e diplomimit etj. Planet mësimore gjenden në SMAK dhe në Pitagorë, por në SMAK ka më shumë fusha ku mund të plotësohen të dhëna.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 29-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës, të analizojë dhe vlerësojë të gjitha mundësitë që informatizimet e pjesshme që ndihmojnë aktivitetin administrativ të universitetit t'i përmbledhë në një sistem informatik të vetëm, çfarë do të lehtësonte mirëmbajtjen dhe suportin nga punonjësit e sektorit IT, por dhe përdoruesit të cilët do të gjenin çdo informacion të nevojshëm brenda një sistemi.

Menjëherë

10.2 Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës, të adresojë në institucionet përgjegjëse çështjet që nuk janë në kompetencën e tij, por rrezikojnë përdorimin apo të dhënat në sistemin Pitagora, në mënyrë që të nxiten të gjithë faktorët për krijimin e kushteve optimale në popullimin dhe sigurimin e të dhënave në këtë sistem të ndërtuar për studentët në vend.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemeve informatike në USh, u konstatua se:

- Nuk ka një udhëzues për sa i përket fjalëkalimeve, si ndryshimet në password, periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit.

- Për periudhën nën auditim, nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve në të cilin të përcaktohen qartë procedurat që do të ndiqen për administrimin dhe monitorimin e përdoruesve. Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email.

- Nuk ka një manual për administratorin e sistemit.

Nga verifikimi në nivel administrativ që grupi i auditimit kreu në sistem lidhur me krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesit, rezultoi se nuk është ndjekur i njëjti standard në krijimin e përdoruesit:

- Në një rast është krijuar sipas modelit emër MBIEMËR;

- Në disa raste janë krijuar sipas modelit emër (Mbiemër) MBIEMËR;

- Në disa raste sipas modelit emër MBIEMËR (Mbiemër).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 29-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Universiteti i Shkodrës të identifikojë dhe të miratojë një standard dhe akt rregullativë mbi menaxhimin e përdoruesve si një mjet i domosdoshëm i cili garanton gjurmën e veprimeve të përdoruesve dhe ofron një identifikim më të sigurt në sistemet informatike.

Menjëherë

11.2 Rekomandimi: Sektori i IT në Universitetin e Shkodrës, në bazë të rregullores së miratuar për përdoruesit dhe standardit të aprovuar për identifikimin e përdoruesit, të bëjë korrigjimet e nevojshme në emërtimin e përdoruesve.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT